



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 83/2019

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT DHE PROPOZIMIT PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR, BAZUAR NË KËRKESËN E NJË GRUPI DEPUTETËSH PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, Z. ILIR META

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 55 dhe 112, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të përhershëm parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, bazuar në kërkesën e 55 deputetëve për shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Miratimin e raportit të Komisionit të përhershëm parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe propozimit për ngritjen e Komisionit Hetimor parlamentar, bazuar në kërkesën e një grupi deputetësh për shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Ilir Meta.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 8.7.2019